




REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVAI REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT	
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE	
ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep.	Nr Prot
Dep. <u>2-0/DLK</u>	Br Prot <u>01-1782/2012</u>
Nr. f. sh.	Data
Broj. stranica	Datum <u>17-05-2012</u>
Nr. pages <u>02</u>	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 29 paragrafi 1 pika e) të Rregullores së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë **03.05.2012**, nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK-03-4793/11, për z. *Teuta Sahatçija* – Deputete në Kuvendin e Republikës së Kosovës, për shkak se janë shmangur situatat me konflikt interesi në të cilën ndodhej kjo Zyrtare e lartë publike.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti, nr. AKK-03-4793/11, i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në ushtrimin e funksionit publik, për Zyrtaren e lartë, znj. Teuta Sahatçija – Deputete në Kuvendin e Kosovës, është trajtuar sipas procedurës së paraparë ligjore, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në ushtrimin e funksionit publik (Ligji Nr. 04/L-051).

Pas identifikimit të rastit, sipas të cilit del se; zyrtarja e lartë ushtron funksion të lartë publik e njëkohësisht edhe funksionw menaxhues në ndërrmarje private, që sipas Ligjit për Parandalimin e konflikt të konfliktit të interesit konsiderohet papajtushmëri funksionesh, zyrtares së lartë i është bërë shkresa e parë njoftuese.

Pas kësaj shkrese njoftuese zyrtarja e lartë, znj. Teuta Sahatçija, është paraqitur në Agjencinë kundër korrupsionit dhe nga zyrtarët e Agjencisë është njoftuar me situatën në të cilën ndodhet, si dhe për mënyren e shmangies së tyre.

Pas këtij takimi zyrtarja e lartë, znj. Sahatçija, me datën 14.03.2012, në Agjencinë kundër korrupsionit, ka sjellë një dokument nga Agjensioni për regjistrimin e bizneseve (ARBK), i protokoluuar në Agjencinë kundër korrupsionit me numër protokoli DPK/DPKI, 03-1025/2012,

për të dëshmuar se nuk gjendet në situatë të konfliktit të interesit. Por, meqenëse ky dokument ka qenë jo i mjaftueshëm dhe jo bindës, znj. Sahatqija është udhëzuar që të sjell komplet dokumentin zyrtar me të gjitha fletëinformacionet nga Agjencioni për regjistrimin e bizneseve në Kosovë.

Këtë znj. Sahatqija e ka bërë me datën 29.03.2012 me ç'rast në Agjenci ka sjellë dokumentin zyrtar nga ARBK-ja me të gjitha informacionet mbi biznesin "IR GROUP" shpk, si dhe për biznesin "Idea-Communication" sh.p.k. nga të cilat shihet se ajo më nuk ushtron postin e personit të autorizuar e menaxhues në asnjërin nga këto ndërmarrje. Në këtë pozitë ndërmarrja "IR GROUP" ka emruar një person të besuar.

Kështu, me këto informacione zyrtare, kemi konstatuar se janë shmangur situatat e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, gjithnjë duke u bazuar në Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në ushtrimin e funksionit publik (Nr.04/L-051).

II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./znj. (zyrtari kontaktues)

Drejtor i Agjencisë Kundër Korrupsionit

/ Hasan Preteni /

